



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 27, DATË 22.04.2020

PËR

SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SUBJEKTIT PERSON FIZIK ISMET DRISHTI
PËR MARRJE LICENCE PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT TË PROGRAMIT
AUDIOVIZIV TË PËRGJITHSHËM “ZJARR TV” NË ALLOTMENTIN TIRANË

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen që i përket:

Kërkues: Subjekti person fizik Ismet Drishti

Objekt Mbi shqyrtimin e aplikimit të subjektit person fizik Ismet Drishti, për marrje licence për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm “Zjarr Tv” në allotmentin Tiranë

Baza Ligjore: Neni 19, pika 16, nenet 60 dhe 61 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullorja “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencës së shërbimit të programit audioviziv”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 02, datë 16.01.2020, vendimi i AMA-s, nr. 5, datë 29.01.2020 “Për çeljen e garës për lëshimin e licencave lokale të shërbimit të programit audioviziv”,

VËREN:

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Për kriteret dhe procedurat

e dhënies së licencës së shërbimit të programit audioviziv”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 02, datë 16.01.2020, si dhe vendimit nr. 5, datë 29.01.2020 të AMA-s “Për çeljen e garës për lëshimin e licencave lokale të shërbimit të programit audioviziv” shpalli garën e kandidatave për:

- Lëshimin e 2 (dy) licencave lokale të shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm, në allotmentin Tiranë. (Qarqet Tiranë dhe Durrës)
- Lëshimin e 1 (një) licence lokale të shërbimit të programit audioviziv informativ, në allotmentin Fier
- Lëshimin e 1 (një) licence lokale të shërbimit të programit audioviziv informativ, në allotmentin Korçë

Në vijim të njoftimit “Për çeljen e garës për lëshimin e licencave lokale të shërbimit të programit audioviziv” të publikuar në faqen zyrtare të AMA-s, si dhe në gazetata “Panorama”, “Tema” dhe “Dita” me shpërndarje kombëtare, subjekti person fizik Ismet Drishti ka depozituar aplikimin nr. 867 prot., datë 09.03.2020, për marrje licence për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm “Zjarr TV” në allotmentin Tiranë (qarqet Tiranë dhe Durrës).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të aplikimit, rezulton se subjekti person fizik Ismet Drishti është regjistruar si person fizik në datën 11.11.2014.

Bazuar në Ekstraktin Historik të Regjistrimit Tregtar të Qendrës Kombëtare e Biznesit (QKB), në datën 27.02.2020, për të dhënat e subjektit person fizik, Ismet Drishti, rezulton se:

- NIPT i subjektit është: L42311017I
- Subjekti është regjistruar si i tillë në datën 11.11.2014
- Objekti i veprimtarisë është: “Veprimtari në fushën e krijimeve dhe transmetimeve audiovizive”.
- Emri tregtar: ZJARR TV
- Email: -
- Tel: 0694299988

AMA në vlerësim të dokumentacionit të aplikimit, mbi propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit (KSHD), ngritur me urdhrin nr. 51, datë 04.03.2020, të Kryetarit të AMA-s, (nr. 837 prot., datë 04.03.2020) konstaton se dokumentacioni i depozituar nga aplikuesi, subjekti person fizik Ismet Drishti, nuk është në përputhje me kërkesat e rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencës së shërbimit të programit audioviziv”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 02, datë 16.01.2020, pasi:

- Referuar ekstraktit të regjistrimit tregtar, printuar nga faqja e QKB-së, forma e organizimit të subjektit është në kundërshtim me kërkesat e parashikuara në nenin 6, “Kërkesat ligjore”, të rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencës së shërbimit të programit audioviziv”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 2, datë 16.01.2020, sipas të cilit: “Licenca e shërbimit të programit audioviziv u jepet personave juridike të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, të cilat kanë si objekt ekskluziv veprimtarinë audiovizive”. Subjekti aplikues është i organizuar në formën e subjektit, person fizik, duke qenë në kundërshtim me këtë kërkesë të rregullores.
- Subjekti ka depozituar vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, por ky dokument nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 14, pika 1.1, germa d., sipas së cilës: “Aplikuesi për licencë shërbimi programi audioviziv duhet të plotësojë kërkesat për kualifikim si më

poshtë: Të dhënat e aplikuesit... vërtetim i gjendjes gjyqësore të aksionarëve të subjektit. Dokumenti i depozituar nga subjekti person fizik Ismet Drisht nuk është i kërkuari, nga akti i mësipërm nënligjor. Vërtetimi i gjendjes gjyqësore është dokument zyrtar që lëshohet nga Ministria e Drejtësisë përmes Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, në zbatim të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, neni 6, pika 16, në të cilën përcaktohet se: “Ministria e Drejtësisë ... mban regjistrin e gjendjes gjyqësore dhe lëshon certifikatat në bazë të atij regjistrimi.” Përmes këtij dokumenti vërtetohet se shtetasi aplikues është apo jo i dënuar për kryerjen e një veprë penale, vërtetim, i cili është i lidhur ngushtë me parashikimin ligjor, neni 61, pika 4 i ligjit tonë organik: “ 4. Licenca e transmetimit audio dhe audioviziv nuk u jepet personave të dënuar për një veprë penale, nëse nuk kanë kaluar 5 vjet nga përfundimi i këtij dënimi.”, parashikuar po ashtu edhe në rregulloren “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencës së shërbimit të programit audioviziv”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 2, datë 16.01.2020 të AMA-s, neni 6, pika 3.

- Referuar rregullores së sipërcituar, kapitali financiar i deklaruar dhe i nënshkruar, duhet të jetë i depozituar dhe i pasqyruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, ndërkohë që subjekti ka paraqitur document nga eksperti kontabël. Po ashtu, subjekti është organizuar në formën person fizik dhe jo person juridik, duke mos paraqitur të dhënat e kapitalit në QKB.
- Aplikuesi ka paraqitur planin e biznesit, përshkrimin e shoqërisë, analizën e tregut, strategjinë e marketingut, burimet e financimit dhe objektivat financiare, por jo me treguesit dhe analizat përkatëse për periudhën e vlefshmërisë së licencës, pra përgjatë aktivitetit që pritet të kryejë përgjatë 8 viteve. Gjithashtu, ky dokument është i pafirmosur dhe vulosur.
- Aplikuesi nuk ka paraqitur parashikimin për shpenzimet dhe të ardhurat për periudhën e licencimit (të ndarë në vite), për të ardhurat, shpenzimet (shpenzime për paga, operative, investime). Subjekti ka paraqitur një fletë ku paraqet shifra totale për shpenzimet dhe të ardhurat që pret të realizojë, i cili është i pafirmosur dhe vulosur.

Përfundimisht, për gjithë sa më sipër, dokumentacioni i paraqitur nga subjekti aplikues nuk është në përputhje me kërkesat e rregullores së sipërcituar.

Për sa më sipër, AMA në zbatim të nenit 14, pika 5 të rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencës së shërbimit të programit audioviziv”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 2, datë 16.01.2020, në të cilën parashikohet se: “Mosparaqitja e njërit prej dokumenteve të mësipërme është kusht skualifikues”, arrin në përfundimin se aplikimi i subjektit person fizik Ismet Drishti, për marrje licence për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm në allotmentin Tiranë, duhet të rrëzohet,

PËR KËTO ARSYE

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në mbështetje të nenit 19, pika 16, neneve 60 dhe 61 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 16 të rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencës së shërbimit të programit audioviziv”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 02, datë 16.01.2020, si dhe vendimit nr. 5, datë 29.01.2020 të AMA-s “Për çeljen e garës për lëshimin e licencave lokale të shërbimit të programit audioviziv”

VENDOSI:

1. Rrëzimin e aplikimit dhe mosdhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm "Zjarr TV" në allotmentin Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas legjislacionit në fuqi.
3. Ngarkohet administrata e AMA-s për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:	Gentian	SALA
Zëvendëskryetar:	Sami	NEZAJ (Kundër)
Anëtarë:	Agron	GJEKMARKAJ (Kundër)
	Gledis	GJIPALI
	Suela	MUSTA (Kundër)